

Editorial/

NËSE NUK KE TURP, BËJ ÇFARË TË DUASH!

Nga **Selim KALEH**



Dëgjoj çdo ditë për **k o r r u p s i o n i n**, mashtrimin, rryshfetin dhe transfertën e parave në mënyrë të paligjshme. Gjithashtu çdo ditë dëgjoj për korrupsionin politik, manipulimin, fallsifikimin dhe besnikëritë e dyshimta. Por shumë rrallë dëgjoj për prishjen e moralit, edhe pse ajo është origjina e së keqes. Njerëzit pyesin për burimin e pasurisë, pyesin se nga i kanë marrë postet, por rrallëherë pyesin për rolin që luan prishja e moralit në të gjitha këto që përmendëm.

Zhvatja e pasurisë publike dhe emërimi nëpër poste i njerëzve mendjelehtë, si dhe të gjitha dukuritë e korrupsionit e kanë burimin tek prishja e moralit. Nëse dëshirojmë të trajtojmë problemin e korrupsionit në një vend, duhet së pari të trajtojmë moralin në jetën publike dhe në jetën politike, madje duhet të trajtojmë çështjen se si të rikthejmë edhe një herë vlerat e larta dhe pozitën e tyre të lartë në shoqëri. Shumë iniciativa të ndërmarra janë përjekur ta nisnin reformën nga prizmi politik apo legjislativ por kanë dështuar deri më tani, për arsye se ata të cilëve u është ngarkuar kjo detyrë nuk kanë kaluar në filtrin e vlerave morale. Si rrjedhojë, rezultati ishte ai që e dinë të gjithë, pra krijimi i një aleance mes njeriut të prishur dhe atij që u përpoq që të bënte

reformë. Gjithashtu disa nisma të tjera janë përpjekur që të gjejnë një zgjidhje për amoralitetin politik përmes legjitimitetit zgjedhor, por përsëri kanë dështuar, sepse baza morale vazhdonte të ishte në të njëjtën gjendje. Si rrjedhojë, llogjika e prishjes morale mbizotëroi mbi të gjitha arsyetimet e tjera për të paktën dy arsye: Së pari, humbja e busullës së "vlerave politike" tek ne, duke ia besuar këtë proces atyre që kanë humbur vlerat e para morale. Së dyti, prishja e vlerave morale më të rëndësishme që lidhen me trashëgiminë tonë historike dhe me trashëgiminë e civilizimit tonë, si dhe me normat e lëvizjes sonë kombëtare që ngrihet mbi besnikërinë për idetë, mbi dashurinë për atdheun, me hedhjen tej të fanatizmave krahinore, mbi sakrificën dhe përkushtimin në punë, mbi vetëmohimin, seriozitetin, eficiencën, durimin, respektin për ligjin dhe për të drejtat e njeriut dhe lirive etj. në emër të besimit të verbër për disa njerëz, madje në emër të të qenurit besnikë ndaj gabimeve të tyre. Si rrjedhojë ne duhet të përjetojmë një etapë që mund ta titullojmë "moralizimi i politikës" pikësëpari, nëse vërtetë dëshirojmë të kemi shpresë për një përmirësim për një periudhë afatgjatë. Kjo nuk mund të arrihet vetëm se duke u nisur nga dy parime: Së pari, konsiderimi i mungesës së respektimit të

vlerave morale islame dhe normave shoqërore si një element që bie ndesh me marrjen e posteve publike, gjë që supozon largimin e personit prej këtyre posteve. Së dyti, demaskimi i të gjitha formave të amoralitetit që manifestojnë njerëzit me pushtet, përndryshe asnjëherë nuk mund të shfarrosim korrupsionin ekonomik dhe politik dhe nuk do të arrijmë të kuptojmë thellë fjalën e të dërguarit të Allahut (a.s.): **"Nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash."**

Nëse njeriu e humbet turpin ka zbritur në nivelin e poshtërsisë, pra në mejdanin e mendjelehtësisë dhe budallallëkut. Si pasojë çdo hap e drejton atë drejt një shkelje tjetër derisa të kthehet në një njeri të mbushur me të meta, me plot vepra dhe fjalë të ulëta. Nëse Allahu

dëshiron ta shkatërrojë një njeri, ia heq turpin dhe nëse ia heq turpin, ai kthehet në një njeri të urreyer. Nëse kthehet në njeri të urreyer, Allahu e bën që të mos e mbajë dot amanetit që i besohet, e si rrjedhojë ai kthehet në një tradhëtar. E nëse kthehet në një tradhëtar, Allahu e zhvesh zemrën e tij nga mëshira, e si rrjedhojë ai kthehet në një njeri zemërgurë. Nëse kthehet në njeri zemërgurë, Allahu ia heq nga zemra imanin, e si rrjedhojë ai kthehet në një shejtan të tërbuar. Nëse nuk ke frikë nga turpi dhe askush nuk arrin të të pengojë dot nga veprat e tua të këqija, atëherë Allahu do të ndëshkojë pa asnjë dyshim për to. Pra Profeti (a.s.) sikur thotë "bëni çfarë të doni" dhe do ta shihni shpërblimin e asaj që gatuat me duart tuaja.

Fq.3/ Analizë/ Hoxhallarët, kategori e respektuar e shoqërisë shqiptare

Fq.4/ Rrymat fetare në Shqipëri

..... Nga hoxhë **Justinian Topulli**

Fq.5/ Disa koncepte të gabuara të adhurimit dhe moralit islam tek masa e shqiptarëve

..... Nga hoxhë **Emerim Koçi**

Fetva/

Gjykimi mbi mohuesin e haditheve të sakta

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite Fetvaja nr. 6280 Volumi 2 fq. 55

Pyetje:

Çfarë gjykimi ka për atë person i cili mohon disa hadithe të sakta të Profetit (alejhissalatu uesselam) që flasin rreth dënimit apo shpërblimit në varr, rreth mi'raxhit, magjisë, shefatit dhe daljes nga Zjarri dhe a lejohet të falemi pas këtyre personave? A t'u japim selam apo të distancohemi prej tyre?

Përgjigje:

Fillimisht kërkohet që njerëzit e dijshtëm rreth shkencës së hadithit t'ua qartësojnë ato hadithe nga ana kuptimore, por dhe nga ana e vërtetimit të autentitetit të tyre. Nëqoftë se pas kësaj vazhdojnë të mohojnë ato hadithe apo t'u japin kuptime të devijuara duke ndjekur pasionet, dëshirat dhe duke i përshtatur sipas logjikës së tyre të kotë, atëherë ata konsiderohen njerëz të shthurur e të prishur.

Që të ruhesh prej të keqes që mund të vijë nga ata, duhet të distancohesh dhe mos të përzihesh me njerëz të tillë, përveç se në rastin kur kërkohet të qëndroshi i lidhur me ta për t'i këshilluar dhe orientuar. Ndërsa namazi pas tyre merr gjykimin e namazit pas njerëzve të prishur, por më e mira për të qenë i sigurtë në këtë çështje mos u fal pas tyre, sepse disa dijetarë i kanë konsideruar njerëz të tillë kafira (femohues).

Studimi i filozofisë dhe logjikës

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite Fetvaja nr. 9406 Volumi 2 fq. 60

Pyetje:

A është e lejuar pjesëmarrja në ato vende ku studiohet filozofia, logjika dhe teoritë nëpërmjet të cilave tallen me ajetet kuranore? A futet kjo gjë te

kuptimi i ajetit kuranor ku Allahu thotë:

“Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rriini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit.” (Nisa, 140)?

Përgjigje:

Nëse pjesëmarrësi është i ditur, ka besim tek vetja dhe nuk ka frikë nga fitneja në dëm të fesë së tij kur i lexon ato studime dhe ka për qëllim që me leximin e tyre t'u japë përgjigjen e duhur teorive të kota – për të triumfuar të vërtetën- atëherë lejohet. Përndryshe është i ndaluar ky lloj studimi dhe përzjerja me njerëz të tillë. Ai duhet të qëndrojë larg gjërave të kota dhe të ruhet nga rreziku i tyre.

Bashkëpunimi me fqinjën e krishterë

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite Fetvaja nr. 8691 Volumi 2 fq. 103

Pyetje:

Si duhet të jetë bashkëpunimi me fqinjën e krishterë në banesë ose në shkollë dhe a lejohet që ta vizitoj dhe ta uroj atë për festat e krishtera?

Përgjigje:

Lejohet bashkëpunimi me fqinjën e krishterë duke i bërë mirë atij, duke e ndihmuar në punët e lejuara, duke u sjellur mirë, duke e vizituar dhe duke e ftuar në rrugën e Allahut të Lartësuar. Ndoshta Allahu mund ta udhëzojë që të pranojë Islamin. Ndërsa prania në festat e tyre dhe urimi për to nuk lejohet. Për këtë Allahu i Madhërishtëm thotë: “Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër” (El-Maide, 2).

Ndërkohë pjesëmarrja në festat e tyre dhe urimi për to është shenjë e miqësisë së ndaluar.

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite Fetvaja nr. 3262 V. 2 fq. 114

Pyetje:

Njëri prej shokëve të shkollës i cili është i krishterë më fton në shtëpinë

e tij për të ngrënë së bashku. A lejohet t'i përgjigjem ftesës së tij kur jam i siguruar që ushqimi në vetvete është hallall sipas rregullave të sheriatit islam? Po ashtu kur qëllon koha e namazit sa jam në shtëpinë e tij e marr sexhaden time dhe e fal namazin para tyre, a është i saktë namazi im kur po e fal atë në këtë shtëpi?

Përgjigje:

Është e lejuar të ushqehesh me atë që të shtron shoku yt i krishterë pa marrë parasysh nëse kjo ndodh në shtëpinë e tij apo në ndonjë vend tjetër. Mjafton që të sigurohesh që ushqimi në vetvete është hallall dhe nuk ke dyshime rreth kësaj.

Në parim kjo është e lejuar përderisa nuk ka argument që e ndalon këtë. Po ashtu qenia e tij i krishterë nuk e ndalon këtë gjë, sepse Allahu i Madhëruar na e ka lejuar ushqimin e krishterëve dhe çifutëve. Gjithashtu, namazi në shtëpinë e tij është i saktë sidomos kur namazet falen në kohën e duhur. Mirëpo është detyrë të përpiqesh sa të kesh mundësi që namazet t'i falësh me xhemat në xhami, sepse ashtu tregon kujdes në mbushjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Masa e fitimit në tregti

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite Fetvaja nr. 4552 Volumi 3 faqja 90

Pyetje:

A ka ndonjë përqindje të caktuar të fitimit në tregti apo fitimi është i papërcaktuar? Dëshirojmë një përgjigje për këtë të shoqëruar me argumentin përkatës dhe mos harroni taksat e shumta që paguan tregtari gjatë vitit.

Përgjigje:

I lejohet atij që blen një mall për tregti apo për pronësi që ta shesë atë më shtrenjtë se çmimi i tij, në atë çast ose në një kohë tjetër; nuk dimë që për këtë të ketë ndonjë kufi i cili kufizon fitimin. Por, më e mira është ulja e çmimit dhe lehtësimi duke u nisur nga tekstet fetare që e nxisin diçka të tillë. Por, nëse kemi të bëjmë me një mall të njohur e që i dihet çmimi që ai ka në atë vend, atëherë muslimani nuk duhet që t'ia shesë atë më shtrenjtë, dikujt që nuk i di çmimet, vetën nëse rast se ia sqaron paraprakisht të vërtetën. Kjo sepse shitja e mallit në këtë rast- me shtrenjtë se çmimi i tij real, është një lloj mashtrimi, ndërkohë që muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën atij padrejtësi, nuk e lë në baltë, nuk e mashtron dhe as nuk e tradhton, por e këshillon kudo

që të gjendet. I Dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) thotë: “Feja është këshillë”. Hadithin e përcjellë Muslimi në Sahihun e tij, ndërsa tek dy Sahihët përcillet nga Xherir ibn Abdullah el Jemani se ka thënë: “I dhashë besën të Dërguarit të Allahut (alejhi salatu ue selam) për të falur namazin, për të dhënë zekatin dhe për të këshilluar çdo musliman.”

Gënjeshtër e mjekut për pacientin

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite Fetvaja nr. 8691 Volumi 2 fq. 103


Pyetje:

Ndonjëherë mjeku është i detyruar që të gënjejë pacientin në lidhje me shëndetin e tij, sepse gjendja e tij nuk e lejon që ta përballojë përshkrimin e drejtëpërdrejtë të gjendjes së tij shëndetësore. A është gjynahqar mjeku në këtë rast?

Përgjigje:

Gënjeshtër është e lejuar në këtë rast nëse ajo nuk i bën dëm pacientit apo dikujt tjetër. Nëse është e mundur mjeku ose mjekja duhet të përdorë fjalë të tërthorta në vend të gënjeshtres së drejtëpërdrejtë. Kjo mënyrë është më e sigurtë dhe më e hijshme. Allahut i përket sukcesi, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi të Profetin tonë, Muhamedin, mb shokët dhe të afërmit e tij.

Kryesia e Përgjithshme për Studimet Shkencore dhe Fetvatë Arabia Saudite



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة البانيا
The Albanian Imam's League



www.lidjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidjahoxhallareve@yahoo.com

Analizë/ Hoxhallarët, kategori e respektuar e shoqërisë shqiptare



Fjala “Hoxh” ë ~ a; shumë ~ allarë, ~ allarët “(Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980), është sinonim i fjalës «mësues». Në një kuptim më të specifikuar kjo fjalë tregon personin që drejton shërbimet fetare në xhami, që u mëson besimtarëve rregullat e dispozitat teologjike, filozofinë, moralin dhe edukatën e fesë islame, mandej jo vetëm si fe; Islami përcakton normat në marrëdhëniet shoqërore në fusha të ndryshme të jetës së njeriut. Janë edhe këto motivet që hoxhallarët gëzojnë respektin popullor. Në historinë e arsimit në botën islame, shkollat e profilizuara që kanë përgatitur hoxhallarë kanë qenë medresetë, nga të cilat kanë dalë dijetarë të shquar.¹ Interesimi për hapjen e një medreseje të tillë në vendin tonë ka lindur si rrjedhojë e faktorëve historikë, nevoja për kuadro si imamë e funksionarë pranë institucioneve, nevoja për mësues feje. Pas shpalljes së «Mëvetësisë» u deshën disa vjet deri në krijimin e aparatit qendror drejtues «Komuniteti Musliman Shqiptar» që do të administronte institucionet fetare dhe vakufet, i pavarur nga Shejhul Islami, ku Vehbi DIBRA ka një kontribut shumë të madh edhe me shkrimet e porositi të tij.²

Ideja e hapjes së medresesë shtronte nevojën e rishikimit të metodave, hartimi i programeve mësimore dhe përcaktimi i objektivave për edukimin e nxënësve me ndjenja kombëtare etj. Medreseja nuk u hap brenda një dite; u desh shumë mund, shumë bisedime, duheshin zgjidhur shumë çështje e nënçështje financiare, duhej siguruar personeli pedagogjik, lokali i mësimin, literatura mësimore didaktike etj.

Ideatorët, flamurtarët e pastaj nismëtarët e kësaj lëvizjeje për ta çuar përpara problemin, u bënë ata që kishin marrë mësim në shkolla të përparuara të botës islame ose që kishin dhënë leksione ndër kësi shkollash si mësues e pedagogë.

Disponohen njoftime e informacione, vepra të botuara, kujtime, fotografi të

ruajtura deri në ditët tona, që mbeten burimet kryesore historike. Autorë të veçantë prezantonin përvojën personale se si mund të themelohej një medrese në shërbim të islamit, në shërbim të atdheut. Hafiz Ali Korça propozonte që programi i mësimin të gjuhëve të huaja, përveç asaj amtare, të ndërtohej me: arabishten, persishten, turqishten dhe frëngjishten.³ Medreseja e Tiranës (Medreseja e Naltë) u hap më 1924, Hafiz Aliu, si profesor i arabishtes, zgjodhi metodën gjermane “Berlitz”; ai ua mësoi arabishten studentëve medresistë me të folur e me shkrim brenda dy viteve dhe ata arritën të përkthenin nga shkencat islame. Profesi i Korçës ndeshi në kundërshtimin e ndonjë konservatori.⁴ Më 1925 H. Aliu botoi librin “Bolshevizma, a çkatrimi i njerëzimit”, që natyrisht influenconte në mënyrën e vet në botëkuptimin e lexuesve të kohës.

Mbi veprimtarinë pedagogjike të Hafiz Aliut shiko Sadik Bega: “Hafiz Ali Korça, pasqyrë e atdhetarizmit për brezin e ri”.⁵ Në artikull ngrihet edhe një herë çështja e metodave bashkëkohore.⁶ Mendohet se ka akoma familje qytetarësh, familje medresistësh të vjetër e familje profesorësh të Medresesë që ruajnë materiale të tilla. Edhe në këtë aspekt nuk mungon përvoja si: ceremonia e shpërndarjes së diplomave më 1932, konferencat e maturanëve të vitit 1945, kremtimi i 75-Vjetorit etj, të organizuara nga Medreseja.

«Dibrani» në shkrimin me titull: «Çka është medreseja e pse duam ta ngrëhim atë», bën fjalë për medresetë e larta të Kordovës që u shkatërruan me egërsi nga inkuizicioni, i cili çrrënjosi qytetërimin islam të Spanjës. Këtë fat pësoi edhe qytetërimi islam i Sicilisë.⁷

Gjatë një periudhe prej shtatë vjetësh, me punë intensive, me mobilizim shembullor mësues–nxënës, u arritën suksese dhe u përgatit matura e parë. Revista «Zani i Naltë» boton shkrimin «Ceremonia e shpërndarjes së

diplomave maturanëve të Medresesë», ku merrte pjesë vetë Ministri i Arsimit i shtetit shqiptar, Hilë MOSI dhe shpërndau diplomat. Gjithashtu ishte i pranishëm edhe Ministri i Drejtësisë, Milto Tutulani.⁸ Shumica e djemve të kësaj mature ndoqën studimet e larta në Kajro, etj.. Pas Luftës së Dytë Botërore medresistët nuk mundnin të vazhdonin studimet në shkollat e përtej kufirit.

Me hapjen instituteve të larta e të fakulteteve të universitetit në vendin tonë, mjaft maturanë medresistë kryen studimet universitare në degë të ndryshme të shkencave e të dijeve dhe punuan me përkushtim në sektorë të arsimit, në institute shkencash etj. Medresistët u angazhuan edhe në detyra të rëndësishme fetare. Ata mbajtën kështu barrën e shërbimeve në xhamitë e qyteteve e fshatrave dhe kudo që shkuan lanë përshtypje shumë të mira me sjelljen e tyre korrekte. Pas vendimeve të mbrapshta të luftës kundër fesë, viti 1967, u shembën të gjitha faltoret, u ndalua kategorikisht ushtrimi i riteve fetare islame. Vetëm me ardhjen e pluralizmit besimtarët muslimanë iu kthyen fesë së tyre. E veçantë e këtij zhvillimi qëndron në faktin që medresistët, që kishin kryer studime të larta ose jo, me përmbysjen e diktaturës, kontribuuan pa rezerva dhe dhanë ndihmesën e tyre për rihapjen e xhamive ose u morën me punë të tjera në shërbim të Islamit, kudo që u ndodheshin në Shqipëri. Ata që nderojnë veten sot me titullin e Hoxhës si edhe shumë besimtarë pa këtë titull nga rinia shqiptare e nga “shoqëria civile”, ia kanë kushtuar veprimtarinë e vet çështjes islame, çështjes së edukimit të shqiptarëve me parimet e Islamit dhe atë të mbrojtjes së identitetit kombëtar e shpirtëror të popullit tonë, duke ruajtur me rigorozitet marrëdhëniet të mira edhe me bashkëkombësit e tyre që u përkasin besimeve të tjera tradicionale. Për të realizuar këtë mision të vështirë, medresistët kanë mbajtur parasysh mësimet e dijetarëve tanë të shquar, të hoxhallarëve të mëdhenj, të pedagogëve të devotshëm e muderrizëve të palodhur të Medresesë, të cilët, pa marrë parasysh vështirësitë e përndjekjet policore të pamëshirshme, punuan dhe derdhën të gjitha forcat e tyre intelektuale e fizike për Islam. Shkrimet e tyre, librat, konferencat, veprat e tyre janë trashëgimi e vyer, e pazëvendësueshme, prandaj duhen lexuar me vëmendje e duhen mbajtur dy herë më shumë si udhërrëfyes, sepse edhe fenomeni i islamofobisë shfaqet tinëzisht kundër veprimtarisë sonë.

Libri me titull «100 personalite të kulturës islame shqiptare», botuar nga K.M.SH. me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, pajisur me fotografi

dhe referenca, është një kontribut me rëndësi të veçantë nga mund të nxjerrim mësim. Sakrificat e jashtëzakonshme të shumicës së këtyre veprimtarëve janë shembuj që nuk duhen lënë në harresë.

E pyetën Hafiz Ibrahim DALLIUN, nëse e kishin rrahur. Përgjigjet Hafizi në mënyrë lakonike: «Nëntë here!» Prof. Kristo FRASHËRI I. DALLIUN e quan **Përfaqësues i brezit të fundit të Rilindasve**⁹ Tek «Revista Pedagogjike» kur flitet për Dalliun, dallohen lehtë nënteksti dhe simptomat e asaj rezistence përballë shantazheve policore.

Tek «100 personalitete» lexojmë biografi për figurat e paraqitura, që i hapin rrugën studimeve të mëtejshme të historisë së Islamit tek shqiptarët. Studiuesit, teologët, dijetarë të fushave të ndryshme kërkimore, medresistë që veshën uniformën fetare dhe që u angazhuan me detyra si imamë myftinj; të tjerë, edhe pa këtë rrobë të nderuar, u mobilizuan, gjurmuan e hulumtuan nëpër arkiva, shfletuan vëllime, zbuluan qindra dokumente rreth historisë së Islamit dhe shkruan vepra origjinale me vlera shkencore. As ata që vijnë nga kontingjenti i hoxhallarëve, as ata nga shoqëria civile, nuk kanë ndryshime esenciale nga tematika e trajtuar, as nga objektivat që synonin të arrinin brenda kuadrit të historisë së qytetërimin e të zhvillimit islam: argumentimet, deduksionet e arritura, faktet filozofike e shkencore të njërës palë, po me aq sukses i përdor edhe pala tjetër. Metodot kërkimore nuk janë të pakapërcyeshme tek njeri-tjetri. Le të ndalemi dhe ta shkoqitim sadopak këtë dukuri:

Dijetari, filozofi, hulumtuesi i apasionuar, Hafiz Ismet DIBRA në serialin e konferencave të veta në xhami ka trajtuar temën «A ka dyshim në qenien e Zotit» dhe shpjegimet e tij i ilustron me argumente nga literatura islame, me ajete e me hadithe, por bisedat e veta ai i ilustron edhe me të dhëna nga shkencat e natyrës, nga korifenjtë e filozofisë e të dijeve shkencore. Citon filozofin De Kart të këtë thënë: «**Kaq i bindur jam në qenien e Zotit, sa jam bindur që shuma e këndeve të një trekëndëshi është baras me dy kënde të drejtë**». Në faqen 71 (botimi i Amerikës) përmend Njutonin, Ainshtajnin e shkencëtarë të tjerë. Pikëpamjet filozofike të Hafiz Ismetit përmbajnë «definicionet» unikalë që i shërbejnë tolerancës e bashkëjetesës mes faktorëve heterogjenë.¹⁰

Ndërsa studiuesi Jonuz Buliqi nuk mbante çallmë; si i tillë mund të radhitet në kategorinë e intelektualëve të shoqërisë civile. Poliglot, matematikan, metodist, njihte mirë...

(Vijon në faqen nr. 5...)

RRYMAT FETARE NË SHQIPËRI

Intervistë nga Ben Andoni, gazetar i uebsajtit "setimes.com" - një burim qendror lajmesh dhe informacioni rreth Evropës Juglindore

Kjo intervistë është bërë në fund të prillit të vitit të kaluar, nga gazetari i mësipërm, por deri më sot nuk është publikuar, kështu që ne e po e publikojmë atë këtu.

Ben Andoni (Gazetar i setimes.com):

1-Si është me pak fjalë historia e kristalizimit të dy rrymave fetare brenda muslimanëve shqiptarë (arabo-shqiptarë)?

2-Si prezantohet ai në komunitetin e besimtarëve?

3-Cili është më afër dogmës dhe cili do reformën?

4-Si e përcjellin njerëzit e thjeshtë këtë ndarje?

Justinian Topulli (Kryetar i LSHH-së):

Në fillim mendova t'iu përgjigjem fare shkurt pyetjeve tuaja, sepse në fakt problemi në thelb është i thjeshtë, mirëpo mënyra sesi ishin ndërtuar pyetjet, në tërësinë e tyre të marra së bashku, tregojnë atë se përfytyrimi që vazhdon të ekzistojë, nga jashtë për komunitetin e muslimanëve nuk është i qartë, dhe pikërisht mbi këtë paqartësi është ndërtuar pasaktësisht edhe ideja e ekzistencës së dy 'rrymave' fetare në këtë komunitet. Shpesh kjo paqartësi 'fut në grackë' padashur edhe anëtarë të këtij komuniteti duke iu dhënë përgjigje pyetjeve, që kanë ndërtuar që më parë, një skemë që nuk qëndron. Kështu që, jam i detyruar t'i zgjas disi shpjegimet, edhe pse ndoshta nuk do të jetë nevoja që ato të përfshihen të gjitha në artikullin që ju do të shkruani, por shpresoj pa e cunuar dhe tjetërsuar thelbin e tyre, siç ndodhë ndonjëherë me shkrimet e gazetave, të cilat i shkëpusin nga konteksti fjalët duke i dhënë tjetër kuptim atyre.

Pyetjeve, duke qenë se përbëjnë një vijë mendimi, do tu përgjigjem në bllok, pa i ndarë ato në mënyrë specifike.

Pyetjet së pari janë ndërtuar mbi një përfytyrim të pasaktë, ato vendosin një ndarje me thikë brenda një komuniteti të vetëm. Ndërtimi i brendshëm i komunitetit të muslimanëve dhe bashkëveprimi mes anëtarëve të tij

buron nga mënyra sesi kuptohet dhe interpretohet feja brenda mes vetë muslimanëve.

Së pari, nuk ekziston ndarje për sa i përket çështjes së doktrinës apo dogmës dhe së paku deri më sot në asnjë nga debatet e zhvilluara mes muslimanëve të Shqipërisë nuk është ngritur si tezë çështja e doktrinës. Dihet se komuniteti musliman i Shqipërisë i përket sunizmit (emërtim ky që tregon doktrinën), i cili përbën gati 90% të botës islame, dhe falë këtij fakti nuk ka ekzistuar ndonjë debat mbi doktrinën që të ndajë në dy rryma muslimanët e Shqipërisë, qofshin këta të rinj apo të vjetër, të shkolluar në vendet arabe apo në Turqi. Vetë mënyra sesi është interpretuar historikisht doktrina islame si dhe mungesa një hierarkie të centralizuar klerikale brenda sunijve ka krijuar një fleksibilitet të atillë që lejon dallime dytësore në interpretimin e doktrinës pa krijuar çarje mes tyre. Madje edhe këto dallime, në mesin e shqiptarëve nuk janë përhapur dhe as janë shfaqur, sa të formojnë rryma mes tyre, sepse niveli i këtyre dallimeve është tepër akademik, për tu kuptuar dhe zhvilluar nga njerëzit e thjeshtë, qofshin këta besimtarë të rinj në moshë apo të vjetër.

Së dyti, për sa i përket çështjeve juridike islame, që përfshin si çështjet e riteve dhe ato të marrëdhënieve ndërnjerzore, fleksibiliteti është akoma më i madh, për vetë faktin që mes sunijve janë kristalizuar dhe pranuar katër shkolla të interpretimit juridik.

Dikur për arsye historike të njohura, vende dhe popuj të caktuar ndiqnin një nga këto shkolla juridike, por ka pasur edhe vende ku besimtarët e atij vendi i përkisnin më shumë se një shkolle juridike islame. Në vendin tonë ka qenë e përhapur shkolla juridike islame sunite hanefite. Pas viteve të gjata të izolimit komunist ishte normale që edhe në Shqipëri muslimanët e këtij vendi të hapeshin dhe të binin në kontakt me shkollat e

tjera juridike islame sunite, por edhe me lëvizje akademike juridike islame bashkëkohore që synojnë interpretime juridike islame sunite ndërkombëtare, kjo jo vetëm për çështje të sotme që kanë të bëjnë me praktikimin e fesë, por edhe ato të trashëguara. Natyrisht është më së normale që të gjejmë pikëpamje të ndryshme në këtë drejtim, dikush më strikt e dikush më tolerant. Dhe pikërisht për këto çështje, për shkak të izolimit të gjatë komunist, padijes, keqkuptimit dhe papjekurisë rinore ka pasur fërkime mes një pjese të të rinjve dhe një pjese të të vjetërve. Me kalimin e kohës këto fërkime janë minimizuar mjaft dhe këndvështrimet e ndryshme në lidhje me atë që përmenda janë kristalizuar duke formuar njëkohësisht edhe një tolerancë më të madhe mes besimtarëve. Ndërkohë pjesa më e madhe e njerëzve të thjeshtë besimtarë e ka përcjellë këtë 'ndarje' në mënyrë të qetë dhe gati indiferente.

Së treti, përplasjet publike që ka pasur mes besimtarëve dhe drejtuesve të KMSH, deri së paku para tre viteve, nuk kanë lidhje fare me atë çka përmenda më sipër. Ato kanë qenë të një natyre krejt tjetër dhe si në radhët e njëres palë dhe tjetres janë përfshirë si të rinj të shkolluar në vendet arabe po edhe të vjetër. Përplasjet kanë qenë për çështje parimore, siç ka qenë çështja e shitjes së vakëfit pranë lapidarit të Azem Hajdarit, zgjedhjes së kryetarit të KMSH, mungesës së transparencës, përjashtimi dhe anashkalimi i besimtarëve intelektual dhe një pjese të mirë të kuadrove të përgatitur jashtë

vendit, moszbatimi dhe manipulimi i statutit të KMSH, përzjerja e politikës dhe e klaneve me interesa aspak fetare etj... që i përkasin kësaj natyre. Por ndërkohë është për të ardhur keq që për të mbrojtur pozitën e tyre dhe për tërhequr pas vetes opinion publik jashtë xhamisë dhe atë politik e ndërkombëtar, këta drejtues apo ish drejtues të KMSH kanë shfrytëzuar qëllimisht ose jo 'imazhin e konfliktit mes dy rrymave' të përhapur në mediat tona, për të mbuluar arsyen e vërtetë të këtyre përplasjeve. Fakt ky që është konstatuar dhe përmendur edhe në një nga kabllogramet e Ambasadës Amerikane të publikuara në WikiLeaks. Vetë qëndrimet antagoniste të këtyre drejtuesve në vite dhe muaj karshi po të njëjtëve njerëz, tregojnë se nuk bëhet fjalë -deri më sot të paktën- për përplasje 'rrymash' radikale dhe reformatore.

I gjithë vendi ynë dhe mbarë shqiptarët në të edhe për shkaqë globale po përjetojnë pas viteve të gjata të komunizmit një transformim si dhe një përballje në mes trashëgimisë subkoshiente të së kaluarës dhe ideve të reja të sotme që vijnë ngado, dhe e gjitha kjo nuk ka sesi të përjashtoj muslimanët e këtij vendi, që natyrisht janë pjesë e kësaj shoqërie dhe këtij transformimi.

Vërtetë ndoshta panorama që solla nuk duket edhe aq interesante për një artikull gazete, por në thelb ky është realiteti pjesë e të cilit ne jemi.

Me respekt,
Justinian Topulli



LSHH MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

DISA KONCEPTE TË GABUARA TË ADHURIMIT DHE MORALIT ISLAM TEK MASA E SHQIPTARËVE

Nga hoxhë Emerim Koçi

1 – Kërkimi i mbrojtjes, i faljes së mëkateve, i shërimit, i martesës nga të vdekurit ose therja e kurbanëve për ta, bërja tavaf rreth varreve të tyre, bërja sexhde në drejtim të tyre, të zotuarit në emër të tyre janë gjëra që kundërshtojnë besimin dhe nuk lejohet t'ia drejtojmë askujt tjetër përveç Allahut të Lartëmadhëruar.

2 – Komentimi i deklaratës islame-shehadetit "La Ilaha il-Allah" me "nukka krijues tjetër pos Allahut". Ky komentim bie ndesh me parimet e pastra kuranore dhe profetike, pasi kuptimi i vërtetë i saj është "nuk meriton të adhurohet askush me të drejtë përveç përveç Allahut".

3 – Bërja e bidateve dhe shumë shirkeve me nijetin e ibadeteve dhe konsiderimi i tyre si mjet afrimi tek Allahu.

4 – Të folurit për fenë e Allahut pa dije dhe argument. Duhet ditur se çdo mendim i shprehur ose fjalë e thënë pa dije dhe argument konsiderohet shpifje ndaj Allahut dhe fesë së Tij.

5 – Të tepruarit në dashurinë për Pejgamberin sal-lallahu alejhi ve sellem me gjëra për të cilat ai nuk na ka porositur.

6 – Të shkuarit te magjistarët dhe

falltorët dhe të kërkuarit ndihmë prej tyre. Të besuarit në fjalët dhe veprat e tyre është mosbesim.

7 – Dashuria për jobesimtarët, fasikët-të prishurit, bidatçinjtë dhe shoqërimi apo përkrahja e tyre dhe urrejtja e besimtarëve, të devotshmëve, pasuesve të Sunetit dhe mosshoqërimi apo mospërkrahja e tyre.

8 – Praktikimi i ibadeteve dhe i çdo pune tjetër me syfaqësi, me qëllim të arritjes së lëvdatave të njerëzve dhe dashurisë së tyre, duke harruar se përfitimi i dashurisë së Allahut është kusht për pranimin e një veprë, kurse ai njerëzve shkak i asgjësimit të veprave.

9 – Mosmbështetja në Allahun (tevekkul) në të gjitha çështjet, me bindje se fuqia dhe potencialet e njeriut janë të mjaftueshme.

10 – Ndërtimi i teqeve dhe tyrbeve mbi varret e njerëzve, zburkimi, stolisja, ndezja e qirinjeve në to me bindje se janë vende të bekuara dhe të paprekshme ose lidhja apo varja e penjve nëpër muret e tyre me qëllim të realizimit të dëshirave.

11 – Parashikimi i fatit të mirë apo të keq nëpërmjet shtazëve apo simboleve. I ngjashëm është edhe parashikimi i fatit

të keq nëse na pret rrugën një mace e zezë etj..

12 – Të zotuarit apo të betuarit me emrat, simbolet dhe famën e njerëzve të ndryshëm konsiderohet shirk, politeizëm.

13 – Të besuarit se ligji i Allahut -Kurani dhe Suneti- nuk është i nevojshëm për këtë kohë ose zëvendësimi i ligjit të Allahut me ligjet e tjera të mangëta të pjella nga logjika e prishura të jobesimtarëve.

14 – Mosfalja e namazit, refuzimi i tij, neglizhenca dhe bindja se mosfalja e tij nuk është gjynah i madh.

15 – Akuzimi i njerëzve me mosbesim pa argumente dhe kushtet e parapara të vendosura nga dijetarët islamë.

16 – Komentimi i emrave dhe cilësive të Allahut me komentime çoroditëse apo përngjasimi i tyre me cilësitë e krijesave, mohimi i kuptimeve të vërteta të tyre apo krahasimi dhe shembëllimi i tyre me gjëra që nuk i përkasin Lartmadhërisë së Allahut.

17 – Bindja se nuk llogaritet mëkat, bidat-risi ose mosbesim fjala apo vepra e dikujt që bie ndesh me Kurandin dhe Sunetin, nëse nijeti i tij është i pastër.

18 – Sharja e shokëve të Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sellem (sahabëve) duke thënë gjëra që kundërshtojnë drejtësinë e tyre apo përshkrimi i tyre me cilësi që njollosin besimin, moralin, edukatën dhe karakterin e tyre.

19 – Sharja e prijësve muslimanë, përhapja e dobësive, të metave të tyre, dalja kundër tyre, akuzimi i tyre me mosbesim pa pasur dije, argumente dhe kushtet e parapara nga Kurani dhe Suneti për këtë gjë.

20 – Mallkimi dhe sharja e dijetarëve, e hoxhallarëve të njohur për qëndrueshmëri në rrugën e drejtë dhe të pastër në pajtueshmëri me metodologjinë e Muhamedit alejhissalatu vesselamu dhe shokëve të tij.

21 – Bindja se lejohet vjedhja e shtetit nëse ai nuk i përmbahet fesë së Allahut apo për shkak të urrejtjes ndaj kryetarëve të shtetit.

22 – Ekstremiteti dhe fanatizmi në mendime, njerëz, medhhebe, dijetarë e hoxhallarë, pa marrë parasysh faktin se çdokush e qëllon të vërtetën apo gabon. I pagabueshëm është vetëm Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sellem dhe shokët e tij si bashkësi.

(Vijon në numrin e ardhshëm...)

(...vijon nga faqja nr. 3)

tekstin e Kuranit. Në polemikën me prelatin e Vatikanit, Atë Pelegrino, i shpjegoi klerikut të lartë brenda të gjitha normave të mirësjelljes, përmbajtjen e dy verseteve kuranore.¹¹

Nga ekipi i pedagogëve përmendim me emër «klasikët», porse nuk janë vetëm këta, që kanë punuar me përkushtim të madh, nga duart e të cilëve dolën disa breza studentësh. Mes tyre zotërues nga dymbëdhjetë gjuhë të huaja Shaban DEMIRI e Vexhi BUHARAJA; Medresisti i shquar, Imam Vehbi ISMAILI, themelues i Qendrën Islame për shqiptarët e Amerikës e të Kanadasë. (Për Vexhi Buharanë më shumë informacion përmban libri «Vexhi Buharaja pa mite e mjegull» i autorit Yzedin HIMA, Tiranë, 2008. Ndërsa në lidhje me Imam Vehbi ISMAILIN shiko edhe gazetën «REPUBLIKA» E dielë, 17 maj 2009, faqe 18-19.) Medreseja kaliste shpirtin e djelmoshave dhe i pajiste me dije të shëndosha islame e laike. Personalitetin e shquar Shaban DEMIRI, atë e njohin më mirë akademikët, gjuhëtarët.

Nga shtresa e "shoqërisë civile" siç i quajtmë ne, vetëm për të lehtësuar sadopak ndonjë vështirësi, pra aktivistët nga kjo shtresë janë angazhuar me shkrime e hulumtime, me punë organizative, të palodhur si veprimtarë për hapjen e xhamive kur triumfoi pluralizmi; të tjerë, moshash të ndryshme rrëmonin nëpër arkiva, shfletonin libra të rralla nga gjuha amtare e gjuhët e huaja. Mes tyre

ndeshim: profesorë universitetesh e institutesh të larta shkencore e artistike me tituj e grada shkencore, mësues e mësuese. Pikëpamjet e tyre, përkthimet, pjesë nga krijimtaria e tyre me tematikë sociale, filozofike rreth Islamit, ku shprehin botën e tyre në prozë apo me vargje plot ndjenja, që u vlojnë në zemër e në shpirt, brenda qenies së tyre, janë botuar në organet e shtypit islam dhe jo vetëm. Të gjithë zënë një vend nderi në historinë e islamit shqiptar. Në këtë kuadër nuk lihen pa përmendur: Prof. Dr. Shefqet NDROQI, Dr. Qazim BAKALLI, me shkrime e veprimtari organizative; Dr. Honoris Causa Faik Luli, me libra me botime; Ismail Muça si publicist, Ali Basha me "trilogjinë" e tij me vlera të mëdha shkencore, Xhemal Balla, i cili ka botuar disa vëllime dhe vazhdon t'i dhurojë lexuesit vepra të tjera. Remzi Sh. Gani, Ismail Dizdari, Muhammed Sytari, Ahmet Çausi etj, kanë botuar artikuj në «Drita Islame», pastaj vazet e tyre (bisedat fetare) në Xhami, janë pëlqyer nga xhemati, (nga dëgjuesit). Zotërinjtë që me të drejtë iu përmenden emrat, dhe jo vetëm këta, janë frymëzuar nga metodat kërkimore të pedagogëve të Medresesë.

Por jeta, aktiviteti, veprat e tyre, dhe jo vetëm të tyre, njihen pak; mandej shumë nga djemtë e rinj e vajzat që vijnë në xhami nuk dinë, nuk kanë informacion. Po të gjithë ne kemi nevojë t'i zgjerojmë njohuritë tona për kontributin e pashembullt që kanë dhënë ata. Me ta krenohen shqiptarët. Prandaj duhet të mos i heqim nga

goja, të mos i lëmë në harresë, duhen përmendur mësimet e porositë e tyre, këshillat si edhe konkluzionet e hulumtimeve të tyre, sepse kështu i shërbehet më mirë Islamit dhe Shqipërisë.

Hoxhallarët e rinj janë pjesë e respektuar e shoqërisë sonë. Pikërisht këta lypset të azhurnohen, mandej të zhyten në studime për t'u njohur me hollësi me të kaluarën tonë, me veprimtarinë e dijetarëve tanë e me aktivitetin e çmuar të ish-medresistëve.

Falënderime të posaçme hoxhallarëve të rinj! Ata do të marrin në dorë në të ardhmen detyra të vështira e do të përballen me situata që lypin zgjidhje të mençura, ashtu sikurse vepruan pararendësit tanë të nderuar në emër të Islamit e të humanizmit.

Falënderime edhe gazetës «LIDHJA» (Lidhja e Hoxhallarëve); aty e ndeshëm atributin "Hoxha" si një mesazh shembullor islam. Shumë urime «Lidhjes»: U bëftë ajo nismëtare e një shoqate të vogël jofitimprurëse e hoxhallarëve të rinj të Tiranës e më gjerë ku, me vullnet të lirë, të anëtarësohen mundësisht imamët, muezinët, lektorët, vaizët, hatibët e kryeqytetit, pavarësisht nga mosha apo stazhi në funksionet që ushtrojnë.

VA'TESIMU BIHABLI L-LAHI XHEMIAN UE LA-TEFERR-RREKU "Lidhuni pas litarit (pas fesë së) së Zotit dhe mos përçani" (Ali Imran, 103)

Me respekt, F. K.

Fundnota:

1. DIBRANI: "Çka asht medreseja e pse duam ta ngrefim": Revista « Zani i Naltë » Viti VI., Nr 3, Mars 1929, faqe 801- 806 & F.K. Bibliografia e revistave "Zani i Naltë , Kultura Islame, Njeriu", Istanbul 2007 , fq 39 , Nr rendor 415.

2. Nekrologji me rastin e vdekjes « Zani i Naltë », Viti XII, Nr 4, Prill 1937, Faqe 97- 120. Fjala e Visarion Xhuvanit, po aty.

3. Hafiz Ali Korça: "Si ishim e si jemi", "Zani i Naltë", Viti I i botimit, Nr. 5. (Fruer 1924, faqe 152- 158 & (Idem " Bibliografia e revistave , faqe 7, Nr R. 59).

4. Hafiz Ali Korça : « RUBAIJJATI , Katroret e Umer Khajjamit », pjesa e parë, Shtypshkronja "Shkodra" – Tiranë, Ramazan 1361, vjeshtë parë 1942, faqe 86, 87.

5. Revista « Kultura Islame », Viti III i botimit, Nanduer-dhetuer 1941, faqe 102-105)& F. Kacollja: Po aty «Bibliografia e revistave » Nr. Rend 370. faqe 176.

6. «Kultura Islame » Viti III i botimit, Numur 5-6-7, Kallnuer --Shkurt- Mars 1942 faqe 144).

7. «Zani i Naltë », Viti VI i botimit, Nr 3, Mars 1929. faqe 801-806.

8.« Zani i Naltë », Viti VIII i botimit, Nr 3-4 Nanduer – dhetuer 1932, faqe 453-475. «Bibliografia e revistave...» Faqe 54, Nr Rendor 593.

9. Për më shumë informacion shiko « Hafiz Ibrahim Dalliu, përfaqësues i brezit të fundit të rilindasve », gazeta « Republika », E mërkurë , 18 gusht 2010 & E enjte 19 gusht 2010), si edhe « Revista Pedagogjike », Organ i Institutit të Studimeve Pedagogjike, Nr 3, Tiranë 1984 , faqe 123- 130).

10. Hafiz Ismet DIBRA «A ka dyshim në qenien e Zotit » ALBANIAN ISLAMIC CENTER HARPER WOODS, MICH., U.S.A.Botimi i parë, 1413~ 1993» (idem Bibliografia FAQE 79).

11. Duhet lexuar materiali : Junuz Buliqi « Një falënderim dhe një mësim ». «Zani i Naltë » Viti XIII i botimit, Numër 4, Prill 1938, faqe e revistës 117-126) & Po aty «Bibliografia e revistave » Faqe 104, Nr.1135

MARTESAT HOMOSEKSUALE, PRINDËRIT HOMOSEKSUALË DHE ADOPTIMI

-Ajo që shpesh harrohet të thuhet-

Nga Gilles Bernheim, Kryerabini i Francës

Martesat homoseksuale në emër të barazisë?

Ajo çfarë dëgjojmë të thuhet: Homoseksualët janë viktimat të diskriminimit. Ata duhet të kenë të drejtën të martohen, si heteroseksualët.

Ajo që shpesh harrojmë ta themi: Fakti që njerëzit duan njëri-tjetrin, jo domosdo pasohet nga e drejta për t'u martuar, edhe nëse ata janë heteroseksualë apo homoseksualë. P.sh. një burrë nuk mund të martohet me një grua që tashmë është e martuar, edhe nëse ata e duan njëri-tjetrin, sikurse e njëjta gjë vlen edhe për rastin kur një grua dashuron dy burra, ajo nuk mund të martohet me ata të dy, nisur nga fakti se ajo i do që të dy dhe secili prej tyre do të jetë bashkëshort i saj. Një baba nuk mund të martohet me bijën e tij, edhe pse dashuria e tyre është unike, prind-fëmijë.

Natyrisht, ne e kuptojmë dëshirën e njerëzve që duan njëri-tjetrin, që dashuria e tyre të njihet ligjërisht. Por, përsëri ka rregulla strikte që përcaktojnë se çfarë lloj bashkimesh mund të njihen si martesë dhe çfarë jo. Shprehja "martesë për çdo njeri" është vetëm një slogan. Edhe pas miratimit për lejimin e martesave homoseksuale, përsëri ligji do të përmbajë forma pabarazie dhe diskriminimi. Këto ndalesa do të vazhdojnë të aplikohen për ata që e duan njëri-tjetrin, por që ligji nuk i lejon të lidhen në një martesë.

Argumenti se të gjithë kanë të drejtë të martohen nuk tregon në fakt dy këndvështrimet e ndryshme që ekzistojnë për martesën. Sipas njërit prej këtyre këndvështrimeve, të cilin unë e ndaj me një numër të madh njerëzish, qofshin këta besimtarë ose jo të tillë, martesat nuk janë vetëm njohja e një lidhjeje dashurie, është institucioni që shpreh bashkimin ndërmjet burrit dhe gruas, si pjesë e vazhdimësisë së brezave. Është institucionalizimi i familjes, pra i qelizës sociale bazë që krijon marrëdhënie dhe lidhje të drejtpërdrejta ndërmjet anëtarëve të saj. Përtej jetës së zakonshme të dy individëve, ajo organizon jetën e një komuniteti, që përbëhet nga paraardhësit dhe pasardhësit. E kuptuar kështu, martesat janë një akt themelor në ndërtimin dhe qëndrueshmërinë e individëve dhe shoqërisë.

Sipas një tjetër mendësie, martesat janë institucion i vjetruar dhe i ngurtë, trashëgimia absurde e traditës dhe e tjetërsimit të shoqërisë. A nuk është pra paradoksale, të dëgjosh ata që ndajnë këtë mendim, të ngrenë zërin e tyre në favor të martesës homoseksuale? Përse ata që refuzojnë martesën dhe preferojnë bashkime të lira, demonstrojnë përkrah aktivistëve LGBT që janë në favor të martesave

homoseksuale?

Cilindo këndvështrim që ju keni, është e qartë se ajo që po ndodh pas sloganit "barazi martesore" është një përmbysje: një institucion i mbarsur me legjitimitet, kulturë dhe domethënie simbolike kërkon të zëvendësohet nga një kategori ligjore shterpë. Kjo padyshim që minon themelin e individëve dhe të familjes. A duhet që ne, në emër të barazisë dhe luftës kundër diskriminimit, t'i japim fund të gjitha referimeve ndaj dallimeve seksuale, në marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve dhe shtetit, duke filluar që nga ceremonia martesore dhe kujtimet familjare që e pasojnë këtë ceremoni?

Martesë homoseksuale për të mbrojtur partnerin?

Çfarë dëgjojmë: Shumë homoseksualë gjenden në situata problematike, pa asnjë mbrojtje ligjore pas një vdekjeje ose një ndarjeje. Martesa homoseksuale do të ofrojë një zgjidhje për këtë çështje.

Ajo që shpesh harrojmë ta themi: Martesa, ose çfarëdo bashkimi civil qoftë, nuk mund të krijojë të drejta dhe përgjegjësi, përderisa ajo të jetë një marrëveshje ligjore. Me fjalë të tjera, miratimi i martesave homoseksuale në Francë nuk do të garantojë automatikisht mbrojtje për të gjithë partnerët, në të gjitha çiftet homoseksuale. Partnerët përsëri do të duhet të martohen. E njëjta gjë vlen edhe për çiftet heteroseksuale, shumë prej të cilëve zgjedhin të jetojnë së bashku pa qenë të martuar.

Shumë çifte heteroseksuale zgjedhin bashkime civile (në Francë pacte civil de solidarité, ose ndryshe PACS) sepse ata e shohin këtë formë bashkimi në interes të tyre, në veçanti në aspektin ekonomik dhe atë ligjor, ku përcaktohen interesat materiale të secilës palë (strehimi, financa, sigurimi social...etj.) Dallimi ndërmjet këtyre dy formave legale është i kufizuar.

Edhe pse dispozita të caktuara u jepen automatikisht çifteve të martuara, çfarë nuk jepet në mënyrë të tillë në bashkimet civile, e megjithatë ato bëhen të mundura. Merrni shembullin e trashëgimisë. Një partner në një bashkim civil mund të trashëgojë nën të njëjtat kushte si një bashkëshort në një çift të martuar, por partneri i tij duhet të ketë hartuar më parë një testament, duke e caktuar atë si trashëgimtar. Si në rastin e PACS, ashtu edhe në rastin e martesës, trashëgimia e partnerit nuk është subjekt i taksës së pasurisë.

Këtu ngrihet çështja e dallimit në pagesat kompensuese, kur një ndarje shkakton një rënie të konsiderueshme në të ardhurat e njërit prej partnerëve, edhe pse partneri në këtë rast mund

të hapë një çështje gjyqësore për të rindarë pronën e përbashkët dhe rishqyrtuar çështjen. Unë dua të shpreh dëshirën time, që të gjenden zgjidhje teknike që do të mbrojnë partnerët në bashkimet civile, në të njëjtin nivel si bashkëshortët e martuar në rast vdekjeje ose ndarjeje.

Unë dëshiroj veçanërisht të theksoj se, në kuadër të bashkimeve civile, tashmë të aplikuara në Francë, nuk ka asnjë arsye që shqetësimi ynë për mbrojtjen e partnerëve të na bëjë të vëmë në pikëpyetje institucionin e martesës dhe në mënyrë kaq radikale, çka ndodh në fakt nëse miratohen martesat homoseksuale.

Prindër homoseksualë në emër të dashurisë?

Ajo çfarë dëgjojmë: ajo çka është më e rëndësishme është dashuria. Një çift homoseksual mund t'i japë shumë dashuri një fëmijë, ndonjëherë edhe më shumë sesa një çift heteroseksual.

Ajo që shpesh harrojmë ta themi: Të duash një fëmijë është diçka; por të duash një fëmijë me një dashuri që i siguron atij një strukturë të domosdoshme është diçka tjetër. Nuk ka dyshim se homoseksualët kanë të njëjtën aftësi të duan një fëmijë dhe ta shfaqin këtë dashuri ashtu si edhe heteroseksualët bëjnë, por roli i prindërve shtrihet përtej dashurisë që ata ndjejnë për fëmijët e tyre. Ta kufizosh lidhjen prindërore tek aspektet emocionale dhe edukative, do të thotë të mos vështrosh faktin se lidhja prind-fëmijë është një vektor psikologjik i një rëndësie themelore për ndjenjën e identitetit të fëmijës.

Edhe gjithë dashuria e botës sikur të mblidhet, është e paaftë të prodhojë struktura psikologjike bazë, që i përgjigjen nevojës së fëmijës që ai ka, për të njohur se nga vjen. Kjo, sepse fëmija e krijon identitetin e tij vetëm përmes një procesi diferencimi, të cilit ai e merr me mend se i ngjan. Kështu që ai ka nevojë të dijë se rrjedh nga dashuria dhe bashkimi ndërmjet një burri, që është i ati i tij, dhe një gruaje, që është e ëma e tij, falë dallimit seksual që ka ndërmjet tyre. Madje edhe fëmijët e adoptuar e dinë se rrjedhin në origjinë nga dashuria dhe dëshira e prindërve të tyre, edhe pse ata nuk janë prindërit e tyre biologjikë.

Babai dhe nëna përfaqësojnë një prejardhje për fëmijën. Fëmija ka nevojë për një prejardhje të qartë dhe koherente, ku ai gjen vendin e tij si individ. Ajo çka e karakterizon dhe do ta karakterizojë gjithmonë humanitetin tonë, është aftësia e gjuhës së folur për të bërë dallime seksuale në mes trupave njerëzorë dhe prejardhjes nga vjen. Po ashtu, më e rëndësishmja, është vendosja e fëmijës në një zinxhir brezash. Vargu i prejardhjes i siguron

çdo individ një vend në botën ku ai jeton, për të ditur se nga ai vjen.

Sot ne përballemi me rrezikun e madh e të pakthyeshem të konfuzionit në zinxhirin e brezave. Ashtu si askush nuk mund ta shkatërrojë themelin e një shtëpie pa shkatërruar vetë shtëpinë, ashtu dhe askush nuk mund të refuzojë themelet e shoqërisë sonë, pa vënë në rrezik vetë shoqërinë.

"Prindërit homoseksualë" nuk janë prindër. Vetë termi është sajuar për të zbutur pamundësinë që kanë homoseksualët për të qenë prindër. Kjo sajësë e re, e shpikur për të përkrahur mundësinë ligjore për t'i dhënë një fëmijë dy "prindër" të të njëjtit seks, është pjesë e një iluzionit.

As martesat dhe as të qenit prindër, nuk kanë qenë ndonjëherë të bazuara në seksualitetin e individëve, por përkundrazi mbi vetë seksin, që bazohet mbi dallimin antropologjik në mes burrit dhe gruas.

Kështu pra, duke braktisur veçorinë e martesës burrë-grua në favor të martesave hetero-homoseksuale, aktivistët homoseksualë nuk kërkojnë thjesht të drejtën për të qenë prind (atësinë ose mëmësinë), por të drejtën e një statusi të ri prindëror abstrakt, që e kufizon rolin e "prindit" në ushtrimin e vetëm disa funksioneve, si p.sh. edukimi. Kjo gjë tejkalon faktin se, edhe në rastet kur kemi adoptim të fëmijëve, të jesh prind nuk do të thotë vetëm të edukosh fëmijë, por gjithashtu të rikrijosh linja atësie dhe mëmësie.

Prandaj ne rikonfirmojmë me forcë se, të jesh baba ose nënë nuk është thjesht një shprehje emocionale, kulturore apo një funksion social. Termi "prind" nuk është asnjëherë; ai përfshin dallimin seksual. Të pranosh termin "prindër homoseksualë" do të thotë ta zhveshësh fjalën "prind" nga trupi i tij esencial, biologjik dhe mishëror i kuptimit.

Organizata e Prindërve Gay dhe Lesbian dhe Prindërit e së Ardhmes, kanë propozuar disa zëvendësime për termin "prind", në varësi të funksioneve të ndryshme që ata do të kryejnë: "prindër-njerk", "bashkë-prindër", "homoseksualë-prindër", "nënë për një tjetër", "prindër biologjikë", "prindër ligjorë", "prindër sociale", "prindër të dytë" etj. Duket e pamundur që një fëmijë të mund të arrijë të gjejë natyrshëm, një kuptim të qëndrueshëm në lidhje me gjithë këto terma.

(Shënim: Shkëputur nga eseja me të njëjtin titull, e shkruar në tetor të 2012-s, nga ish-Kryerabini i Francës, rreth legalizimit të martesave homoseksuale në Francë.)

(Vijon në numrin e ardhshëm...)

KALENDARI ISLAM

Nga hoxhë dr. Abdullah (Gazmir) Nabolli

(...vijon nga numri i kaluar)

Muaj të tjerë të begatë

Muaj me vlerë të veçantë është edhe muaji i Shabanit se në atë muaj ngrihen punët për te Allahu dhe Profeti alejhi selam agjëronte shumë në këtë muaj.

Transmetohet Usame bin Zeid se e ka pyetur Profetin alejhi selam: "O i dërguari i Allahut nuk të kam parë të agjërosh në ndonjë muaj prej muajve më shumë sesa në Shaban? Ai tha: "Ai është një muaj që njerëzit shkujdesen ndaj tij është mes Rexhepit dhe Ramazanit. Ai është muaji kur ngrihen punët për te Zoti i botëve." (E transmeton Imam Ahmedi dhe Nesai dhe e saktëson sheikh Albani).

Ndër muajt më me vlerë gjatë vitit përveç atyre që përmendëm është edhe muaji i Ramazanit. Vlera e këtij muaji vjen për shkak se në të ka zbritur Kurani. Thotë Allahu në Kuran: "Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin ka zbritur Kurani, udhëzim për njerëzit, qartësues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga e kota). Ai që prezanton në këtë muaj, të agjërojë" (Bekare, 185).

Zbritja e Kuranit e përmendur në këtë ajet është për qëllim zbritja nga Leuhil-Mahfudh për në qiellin e dynjasë dhe kjo ka ndodhur në natën e Kadrit e cila është prej netëve të Ramazanit siç thotë Ibn Abasi radiallahu anhu: "Është zbritur Kurani natën e Kadrit nga qielli më i lartë në qiellin e dynjasë njëherazi pastaj është ndarë sipas viteve (d.m.th.: është ndarë zbritja e tij mbi Profetin alejhi selam)." E transmeton Hakimi dhe e saktëson Imam Dhehebiu.

Zbritja e Kuranit si udhërrëfyes për mbarë njerëzimin është mirësia më e madhe që u ka bërë Allahu njerëzimit prandaj dhe u ka kërkuar agjërimin e ditëve të Ramazanit si falënderim për këtë mirësi ndërsa netët e tij ia ka kushtuar Kuranit duke e lexuar atë nëpër taravi.

Festat në Islam

E përmendëm më lart se xhumaja është festa e javës, por në Islam ka edhe festa vjetore që janë: Festa e Fitrit (Çeljes) ose e Bajramit të madh e cila është dita e parë e muajit Sheval menjëherë pas mbarimit të muajit të Ramazanit, festa e Kurbanit ose festa e Bajrami të vogël e cila është dita e dhjetë e muajit Dhul-Hixhe dhe e pasojnë atë edhe tre ditë të tjera që quhen ditët e Teshrikut. Festë është edhe dita Arafatit (dita e nëntë e muajit Dhul-hixhe) pra, një ditë para bajramit të vogël edhe pse mënyra e festimit ndryshon nga dy festat e tjera.

Transmetohet nga Aishja radiallahu anha se Ebu Bekri shkoi tek ajo në ditën e çeljes ose ditën e kurbanit. Aty ishin Profeti alejhi selam dhe dy

vajza të vogla që këndonin me dajre siç kishin kënduar ensarët në luftën e Buathit dhe Ebu Bekri u tha: Fyelli i shejtanit në shtëpinë e të dërguarit të Allahut? Profeti alejhi selam i tha: "Lëri ato o Ebu Bekr, se çdo umet ka një festë dhe kjo ditë është festa jonë." (E transmeton Buhariu dhe Imam Ahmedi).

Transmetohet nga Enes bin Malik se kur mbërriti Profeti alejhi selam në Medine, ata kishin dy ditë ku zbaviteshin dhe dëfreheshin në to, Profeti alejhi selam pyeti? "Çfarë janë këto dyditë?" Ata i thonë: dëfreheshim në to në xhahilije (në kohën para islamit). Ai u thotë: "Allahu ua ka ndërruar ato me dy më të mira: Dita e çeljes dhe dita e kurbanit." (E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson shejh Albani).

Transmetohet nga Ukbe bin Amir se Profeti alejhi selam ka thënë: "Dita e Arafatit, dita e kurbanit dhe tre ditët e teshrikut (janë quajtur kështu se në kohët e hershme në këto ditë thanin në diell mishin e kurbanit) janë festat tona, ne pasuesit e Islamit." (E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson shejh Albani).

Thamë se festimi i ditës së Arafatit ndryshon nga dy festat e tjera dhe kjo sepse Profeti alejhi selam ka nxitur çdo njeri prej umetit të tij që është jashtë haxhit të agjërojë atë ditë. Thotë Profeti alejhi selam: "Agjërimi i ditës së Arafatit, shpresoj te Allahu të fshijë gjynahet e vitit të kaluar dhe vitit që vjen pas." (E transmeton Muslimi).

Ndërsa ai që është brenda haxhit (duke kryer ritet e haxhit) feston duke qëndruar në Arafat dhe duke iu lutur Allahut për falje sepse kjo është ditë ku Allahu fal shumë njerëz. Thotë Profeti alejhi selam: "Nuk ka ndonjë ditë ku Allahu liron më shumë njerëz nga zjarri i Xhehenemit sesa dita e Arafatit. Ai afrohet nga ata dhe krenohet para melaikeve duke thënë: Çfarë duan këta (njerëz)!" (E transmeton Muslimi).

Ditë të tjera me vlerë të veçantë

Përveç ditëve të festave ka edhe ditë të tjera me vlerë te Allahu. Këto janë: dita e Ashures, gjashtë ditë nga muaji i Shevalit dhe dhjetë ditët e para të Dhul-Hixhes që i paraprijnë festës së bajramit.

Vlera e ditës së Ashures ka ardhur për shkak se Allahu në të ka shpëtuar Musain alejhi selam nga Faraoni i Egjiptit siç thotë Ibn Abasi radiallahu anhu: "Kur mbërriti Profeti alejhi selam në Medine i gjeti çifutët duke agjëruar ditën e Ashures dhe profeti alejhi selam u thotë: Çështje kjo ditë? Ata i thanë: Kjo është ditë e madhe. Allahu e ka shpëtuar në këtë ditë Musain alejhi selam bashkë me popullin e tij. Musai e ka agjëruar këtë ditë si falënderim për Allahun prandaj dhe ne e agjërojmë atë. Profeti alejhi selam u thotë: "Ne e meritojmë më shumë sesa ju ndjekjen e Musait." E agjëroi Profeti alejhi selam

atë ditë dhe i urdhëroi myslimanët ta agjërojnë atë." (E transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Thotë Profeti alejhi selam: "Agjërimi i ditës së Ashures, shpresoj te Allahu të fshijë gjynahet e vitit të kaluar." (E transmeton Muslimi).

Kurse vlera e gjashtë ditëve nga muaji Sheval vjen për shkak të Ramazanit se Shevali është muaji që e pason atë dhe agjërimi i gjashtë ditëve nga ky muaj pas plotësimit të Ramazanit është i barabartë me agjërimin e vitit. Transmetohet nga Ebu Ejub El-Ensari se Profeti alejhi selam ka thënë: "Kush agjëron Ramazanin dhe e pason atë me gjashtë ditë nga Shevali është si agjërimi i vitit." (E transmeton Muslimi).

Ndërsa për vlerën e dhjetë ditëve të para të para të Dhul-Hixhe thotë Profeti alejhi selam: "Nuk ka ditë më me vlerë te Allahu dhe as punët e mira të jenë më të dashura te Allahu se sa në këto dhjetë ditë". I thonë: as xhihadi në rrugën e Allahut? Ai u thotë: "As xhihadi në rrugën e Allahut përveç dikujt që del së bashku me pasurinë e tij dhe nuk kthehem më." (E transmeton Buhariu).

Ditë të ndaluara për agjërim gjatë vitit

Gjatë vitit është i ndaluar agjërimi i ditës së çeljes që është bajrami i madh dhe ditës së kurban bajramit që është bajrami i vogël siç thotë Ebu Hurejra se Profeti alejhi selam ka ndaluar agjërimin e dy ditëve: ditës së kurbanit dhe ditës së çeljes. (E transmeton Muslimi).

Gjithashtu të ndaluara për agjërim janë edhe tre ditët pasuese të ditës së kurbanit dhe nuk përjashtohen nga ky gjykim veçse ata që janë më haxh dhe nuk kanë mundësi të therin kurban.

Thotë Nubeishe El-Hudheli se Profeti alejhi selam ka thënë: "Ditët e teshrikut (ditët e tharjes së mishit të kurbaneve dhe që janë tre ditët pasuese të ditës së kurbanit) janë ditë ngrënie dhe pirje" (E transmeton Muslimi).

Thotë Ibn Omeri radiallahu anhu: "Nuk është lejuar të agjërojë ditët e teshrikut veçse ai që nuk ka kurban (prej haxhilerëve)." (E transmeton Buhariu).

Netët e begata të vitit

Gjatë vitit ka edhe netë me vlerë të veçantë: nata e mesme e muajit Shaban dhe nata e Kadrit.

Në natën e mesme të Shabanit Allahu falë gjynahet e njerëzve që nuk bëjnë shirk dhe nuk i mbajnë mëri njeri-tjetrit siç transmetohet nga Muadh bin Xhebel, Ebu Thalebe El-Khushej, Abdullah bin Amr, Ebu Musa El-Esharij dhe Ebu Hurejra se Profeti alejhi selam ka thënë: "Allahu i Madhëruar u shfaqet krijesave të tij natën e gjysmës së muajit Shaban dhe i falë ata përveç mushrikut dhe atij që i

mban mëri tjetrit." (E saktëson Sheikh Albani).

Kurse nata e Kadrit vlera e saj vjen nga katër gjëra:

1- Zbritja e Kuranit siç thotë Allahu i Madhëruar: "Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) natën e Kadrit" (Kadr, 1).

2- Punët e mira në këtë natë shumëfishohen sa e bëjnë atë më të mirë se një mijë muaj siç thotë Allahu në Kuran: "Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj." (Kadr, 3).

3- Zbresin Melaiket dhe Xhibrili me caktimeve të vitit siç thotë Allahu në Kuran: "Në të zbresin melaiket dhe shpirti (Xhibrili) me caktimin e çdo gjëje." (Kadr, 4).

4- Kush e kalon atë natë me namaz i falen të gjitha gjynahet e kaluara siç thotë Profeti alejhi selam: "Kush e kalon në namaz natën e Kadrit duke besuar në shpërblimin e Allahut dhe duke e llogaritur atë, i falen gjynahet e kaluara." (E transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Fillimi i kalendarit islamik

Imam Ibn Kethir thotë në librin e tij "El-Bidaje ue En-Nihaje": "Vjen një burrë te Omeri radiallahu anhu dhe i paraqet një letër ku ishte regjistruar një borxh si dëshmi kundrejt një burri tjetër dhe në të shkruhej se data e shlyerjes së tij është muaji Shaban.

E pyet Omeri radiallahu anhu: Cili Shaban, Shabani i këtij viti apo Shabani i vitit kaluar, apo Shabani ardhshëm?

Atëherë Omeri radiallahu anhu mbledh sahabët për t'u konsultuar me ta rreth vënies së një kalendarit për regjistrimin e borxheve dhe u dhanë disa mendime prej tyre.

Dikush sugjeroi të përdoret kalendarit persian, dikush tjetër që të përdoret kalendarit romak të cilët i referoheshin në llogaritjen e viteve Aleksandrit të Maqedonisë, por Omeri radiallahu anhu nuk e pëlqeu këtë gjë.

Dikush tha: t'i referohemi në llogaritje lindjes së profetit alejhi selam, dikush tha: dërgimit të tij si profet, dikush tha: hixhretit (emigrimit të Profetit alejhi selam në Medine) dhe dikush tha: vdekjes së Profetit alejhi selam.

Omerit radiallahu anhu i pëlqeu t'i referoheshin hixhretit se me të u nda e vërteta nga e kota dhe ranë dakord me këtë mendim të gjithë sahabet. Pastaj caktojnë Muharremin si muajin e parë të vitit, sepse është muaji kur kthehen haxhilerët nga haxhi dhe është muaj i shenjtë.


Kjo ishte një përmbledhje e shkurtër e kalendarit islamik ku tregohen: ndarjet e tij, veçoritë dhe zanafilla e tij.

Lus Allahun e Lartësuar ta rezervojë këtë punë për atë ditë kur nuk bën dobi asgjë veç punëve të mira. Amin!



NA VIZITONI NË KANALIN TONË NË YOUTUBE

Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Edglis, Kati i tretë
Email: lidjahoxhallareve@yahoo.com



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589

www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com

